



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje

Drejtoria për Arsimit

Odeljenje za Obrazovanje

Department for Education

-IV- Nr. I prot. 1406 Më 15.07.2026
Br. prot. Dt. 2026
RAHOVEC - ORAHOVAC

Raport i DKA – së në përfundim të vitit mësimor 2025/2026

Përgjatë gjithë vitit mësimor 2025/2026 në kuadër të DKA-së u realizuan një varg aktivitete, të cilat ishin të parapara të zhvilloheshin edhe në Planet Vjetore të Punës për të dy vitet kalendarike. Këto aktivitete të zhvilluara gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të shkruara në këtë raport, sipas periudhave, siç vijon:

Periudha e tremujorit të parë (shtator – nëntor)

Aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe janë të paraqitura në raportet e kaluara. Në këtë raport i kemi paraqitur aktivitetet e DKA-së për gjysmëvjetorin e dytë.

Periudha e tremujorit të dytë (dhjetor – shkurt)

- Procesi mësimor për gjysmëvjetorin e dytë i planifikuar të filloj më datë 8 janar 2026 u shtye për datën 12 janar 2026 për shkak të vërshimeve në komunën tonë.
- Më datë 12 janar 2026 filloi procesi i rregullt mësimor në të gjitha institucionet edukativo – arsimore, në përjashtim të shkollës “Skënder Kastrati” në Malësi të Vogël dhe shkollës “Gëzim Hamza – Piktori”, të cilat patën vështirësi me ngrohjet qendrore ku si pasojë procesi mësimor filloi dy ditë më vonë.
- Ka vazhduar furnizimi me lëndë djegëse në të gjitha shkollat e komunës sonë.
- Janë sanuar defektet me ngrohje në shkollën “Skënder Kastrati” (është rregulluar kabloja e cila ishte djegur nga tensioni i rrymës) dhe në shkollën “Gëzim Hamza – Piktori” ku është investuar në blerjen e një aparati përforcues për rritjen e tensionit të energjisë elektrike.
- Është nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet DKA Rahovec dhe OJQ "VOLONTARI EL MONDO RTM". Kjo Marrëveshje mirëkuptimi formalizon bashkëpunimin ndërmjet OJQ "Volontari nel Mondo Rtm" në vijim si RTM dhe Komunës së Rahovecit- DKA, të përfaqësuar nga Drejtori i DKA -së, për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Rezultatit 2 të projektit WEMPOWER- mbështetje për aftësimin profesional,

punësimin dhe ndërmarrësinë e grave në shërbimet edukative për fëmijërinë e hershme në Kosovë të financuar nga Agjencia Italiane për bashkëpunim për zhvillim.

- Është nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet IAAP “Selajdin Mullaabazi - MICI” dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit, me qëllim të realizimit të praktikës profesionale për nxënësit e drejtimit të Ekonomisë dhe Juridikut në institucionet e Komunës sonë.
- DKA mbajti takim me drejtorët e shkollave të Komunës së Rahovecit. Në këtë takim u diskutua për procesin e licencimit dhe rilicencimit të mësimeve, si dhe për themelimin e një ekipi funksional me qëllim planifikimin, mbikëqyrjen dhe mbështetjen e shkollave në realizimin e vlerësimit të brendshëm të këtij procesi.
- Është funksionalizuar ekipa me qëllim planifikimin, mbikëqyrjen dhe mbështetjen e shkollave në realizimin e procesit të vlerësimit të mësimeve për licencim dhe rilicencim.
- Me drejtuesit e shkollave, u bashkëbisedua për planin dhe programin e punës së pedagogëve dhe psikologëve shkollorë, si dhe për gjetjen e mundësive për zgjerimin e aktiviteteve të tyre, me qëllim trajtimin e kërkesave të të gjitha shkollave të komunës sonë.
- DKA ka hartuar Planin e Veprimit për aktivitetet e psikologëve dhe pedagogëve, i cili synon shfrytëzimin sa më efikas të kapaciteteve ekzistuese dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të gjitha shkollat e komunës. Ky plan përfshin aktivitete të strukturuar në fushën e këshillimit psikologjik, mbështetjes psiko-sociale të nxënësve, parandalimit të dukurive negative, përkrahjes së mësimeve në menaxhimin e klasës, si dhe bashkëpunimit me prindërit.
- Kemi hartuar Planin e Veprimit të DKA për reforma në sistemin arsimor të Komunes së Rahovecit
- Kanë vazhduar të bëhen vizita sistematike nga Policia e Komunitetit nëpër shkolla.
- U mbajt kuiz i diturisë ndërmjet nxënësve të katër shkollave fqinje me pjesëmarrjen e ShFMU-ve “Katër Dëshmorët”, “Tre Dëshmorët”, “Rudolf Walther” dhe “Rilindja”.
- Organizim i aktiviteteve për nder të 17 Shkurtit – Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
- Kemi pritur në takim përfaqësues të KoSed, (z. Robert & znj. Tanja), ku u dakordua që ata ta zhvillojnë aktivitetet monitorimi të procesit mësimor në dy shkolla të komunës sonë (ShFMU “Bekim Sylka” dhe ShFMU “Bajram Curri”).
- Është rregulluar një pjesë e rrethojës në ShFMU “Gëzim Hamza – Piktori”.

- SHL Kosova me grupin e artistëve, kanë realizuar piktura, murale dhe kanë rregulluar pjesë të oborreve në disa shkolla të komunës sonë.
- Kemi shqyrtuar dhe vlerësuar dosjet e mësimeve për të përzgjedhur mësuesin e vitit për emimin “Shaban Jashari”.
- Në projektet kapitale, kanë rifilluar punimet në finalizimin e objektit të SHFMU “Katër Dëshmorët” në Ratkoc.
- Me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), në bashkëpunim me të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës, organizoi një program të veçantë festiv.
- Në hapësirat e Shfmu "Gëzim Hamza – Piktori", u zhvillua aktivitet me nxënës në lëndën e Matematikës për nder të 14 Marsit, Ditës së Numrit Pi.
- U formua dhe u funksionalizua Komisioni për Vlerësimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta.
- Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi që të jemi pjesë e aktiviteteve të SHPIK-ut, duke u angazhuar në iniciativa globale si Hour of Code, Hour of AI dhe Bebras Computing Challenge.
- U organizuan aktivitete për nder të Javës së Shkencës në SHML “Xhelal Hajda - Toni”.
- Pjesë e aktiviteteve të programit “DREJT MALIT”, të organizuar nga Ministria e Arsimit në bashkëpunim me DKA Rahovec dhe Federatën e Sportit Shkollor, ishin nxënësit e klasave të gjashta nga katër shkolla fillore të komunës sonë: “Bekim Sylka”, “Dëshmorët e Lirisë”, “Liria” dhe “Vëllezërit Frashëri”.
- U realizua me sukses aktiviteti i titulluar "Promovimi i vlerave humane "Shfmu Selajdin Mullaabazi – Mici”
- U shënuar Dita e Shkollës së Muzikës “Faik Sylka” në Rahovec.

Periudha e tremujorit të tretë (mars – maj)

- Në projektet kapitale, kanë rifilluar punimet në finalizimin e objektit të SHFMU “Katër Dëshmorët” në Ratkoc.
- Me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), në bashkëpunim me të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës, organizoi një program të veçantë festiv.
- Në hapësirat e Shfmu "Gëzim Hamza – Piktori", u zhvillua aktivitet me nxënës në lëndën e Matematikës për nder të 14 Marsit, Ditës së Numrit Pi.

- U formua dhe u funksionalizua Komisioni për Vlerësimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta.
- Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi që të jemi pjesë e aktiviteteve të SHPIK-ut, duke u angazhuar në iniciativa globale si Hour of Code, Hour of AI dhe Bebras Computing Challenge.
- U organizuan aktivitete për nder të Javës së Shkencës në SHML “Xhelal Hajda - Toni”.
- Pjesë e aktiviteteve të programit “DREJT MALIT”, të organizuar nga Ministria e Arsimit në bashkëpunim me DKA Rahovec dhe Federatën e Sportit Shkollor, ishin nxënësit e klasave të gjashta nga katër shkolla fillore të komunës sonë: “Bekim Sylka”, “Dëshmorët e Lirisë”, “Liria” dhe “Vëllezërit Frashëri”.
- U realizua me sukses aktiviteti i titulluar "Promovimi i vlerave humane “Shfimu Selajdin Mullaabazi – Mici”
- U shënua Dita e Shkollës së Muzikës “Faik Sylka” në Rahovec.
- Kemi shqyrtuar raportin e Ekipës për Vlerësimin e Fëmijëve me Nevoja të veçanta për dy nxënës së ShFMU “Katër Dëshmorët” në Ratkoc.
- Shënimi i Ditës së Shkollës “31 Marsi” në Guri i Kuq.
- Kemi filluar procesin e Vlerësimit të Performancës së drejtorëve dhe procesin e Vetëvlerësimit të shkollave.
- Kanë vazhduar të mbahen ligjërata nga Policia e Komunitetit për nxënësit e shkollave fillore në një temë tjetër të planifikuar për muajin prill, pasi që procesi mësimor rifilloi më 13 prill 2026, pas pushimit të pranverës.
- Kemi nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Departamentin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.
- Takim më një donator nga Krusha e Madhe i cili ka shprehur gatishmërinë për të investuar në ndërtimin e parkingut në oborrin e cerdhes, “Tulipanët”.
- Në bashkëpunim më DKRS-në, kemi organizuar vizitë me nxënës të tri shkollave në objektet e trashëgimisë kulturore të komunës sonë.
- Shpallja e Konkursit për Bursë për studentë dhe nxënës.
- Në kuadër të “Ditës së Tokës”, janë organizuar aktivitete simbolike në të gjitha institucionet edukative – arsimore të komunës sonë.
- Organizimi i pjesëmarrjes së nxënësve të shkollave të mesme në Olimpiadën e Kimisë në Prishtinë.

- Është organizuar Gara Komunale e Olimpiadës së Gjuhës shqipe me nxënës të klasave të nënta të të gjitha shkollave të komunës sonë.
- Nxënësit e IAAP-së kanë marrë pjesë në Olimpiadën e Ekonomiksit 2026, organizuar nga RIINVEST në Fakultetin Ekonomik të UP-së.
- Kemi marrë pjesë në kremtimin e Ditës së Shkollës në disa shkolla.
- Ka vazhduar aplikimi i studentëve dhe nxënësve në konkursin për ndarjen e bursave. Afati i aplikimit vazhdoi deri më 20 Maj 2026;
- Kanë vazhduar vizitat e dyta sistematike shendetësore të nxënësve të klasave të para dhe te pesta.
- Ekipi i psikologëve dhe pedagogëve vazhdoi me vizita pune në shkolla të komunës.
- Ekipa për Vlerësimin e Fëmijëve me nevoja të vecanta ka bërë vlerësimin e një nxënësit në ShFMU “Heronjtë e Kosovës” në Hoce të Vogël.
- Ligjeratë online me Volontari Del Mondo.
- Kemi pritur në takim anëtarë të Asamblesë së Nxënësve.
- Është mbajtur testi me shkrim i kandidatëve që kanë aplikuar në konkursin për drejtorë të shkollave.
- Kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për mbajtjen e Kuizit të Diturisë në nivel komunal.
- Kemi kontaktuar donatorin, Agron Berisha, dhe në bisedë më të, ka shprehur gatishmërinë të dhurojë 4 tablet “Lenovo” për nxënësit fitues të Kuizit të Diturisë.
- Kemi përpunuar rezultatet e nxënësve të shkollave nga Kuizi i Diturisë të mbajtur me datë 20.05.2026.
- Ka përfunduar faza e aplikimit të studentëve dhe nxënësve për bursa dhe jemi duke sistemuar të dhënat sipas kushteve të konkurrist.
- Është mbajtur intervista me kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim në konkursin për drejtorë të shkollave.

Periudha e fundit (qershor – korrik)

- Më 2 qershor, u mbajt finalja e Kuizit të Diturisë, ku fitues dolën nxënësit e ShFMU “Rudolf Walther” – Dejnë të cilëve iu ndanë tabletët që i dhuroi donatori Agron Berisha.
- Lidhur me Planin e Prokurimit Publik të Drejtorisë së Arsimit, nga gjithsej 12 projekte të planifikuara për vitin 2026, një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë përfunduar procedurat e tenderimit dhe aktualisht ndodhen në fazën e nënshkrimit të kontratave.
- Ndërkohë, projektet e tjera janë në proces të zhvillimit të procedurave të prokurimit, sipas afateve dhe dinamikës së paraparë. Drejtoria është duke monitoruar vazhdimisht ecurinë e të gjitha projekteve me qëllim të realizimit të tyre në kohë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.
- Më datë 16 qershor, u mbajt Test Vlerësues me klasat e treta të të gjitha shkollave të komuns sonë.
- Është nënshkruar kontrata për sigurimin e fëmijëve të institucioneve të edukimit të hershëm.
- Këshilli i prindërve të ShFMU “Isa Boletini” në bashkëpunim me prindërit donatorë, drejtuesit e shkollës dhe DKA-në, kanë pajisur 4 dhoma mësimi të kësaj shkollë me tabela digjitale.
- Më 20 qershor u mbajt Testi i Maturës për maturantët në mbarë vendin. Në test morën pjesë 300 maturantë nga shkollat e mesme të komunës sonë.
- Më 22 qershor Drejtori i Arsimit së bashku me zyrtarë të DKA-së morën pjesë në inaugurimin e një donacioni nga dy donatorë të këtij vendbanimi, të cilët kontribuan në blerjen dhe vendosjen e perdeve në të gjitha klasa e shkollës “Heronjtë e Kosovës” në Hocë të Vogël.
- Më 26 qershor u mbajt Testi i Arritshmërisë në nivel vendi. Në komunën tonë, testit ju nënshtruan gjithsej 609 nxënës të shpërndarë në 4 qendra testimi.
- Në kuadër të bashkëpunimit për të krijuar kushte sa më të mira për fëmijët, në cerdhen e fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec, falë mbështetjes së donatorëve, si dhe participimit të prindërve, është bërë e mundur sigurimi i pajisjeve (4 kondicionerë – klima, 24 BTU), në mënyrë që fëmijët të qëndrojnë në një ambient më të freskët, më të sigurtë dhe më komod gjatë sezonit veror.
- Janë bërë të gjitha përgatitjet për pranimin e nxënësve në të gjitha shkollat e mesme dhe në IAAP të komunës së Rahovecit.

- Më 7 korrik filloi procesi i regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme dhe në IAAP dhe ky process do zgjasë deri më 9 korrik.
- Kemi ndërhyrë në ndarjen e klasave në objektin e SHFMU "31 Marsi" dhe në përshtatjen e këtij objekti për të mbajtur mësim në një ndërrim për nxënësit e kësaj shkolle;
- Në kuadrin e projektit të riparimeve, punime janë duke u zhvilluar ne riparimin i nyjeve sanitare në shkollën "Faik Konica" në Celinë.
- Është funksionaluar komisioni për vlerësimin e projekteve të shkollave për lëndët zgjedhore.
- Po vazhdon sistemimi i msimdhënësve sipas planifikimeve të shkollave.
- Jemi duke u përgatitur që në bazë të kërkesave të shkollave që dalin nga planifikimet e tyre, të hapim konkurse për plotësim të kuadrit.

Muhamet Morina

Drejtor i DKA-së

Rahovec

15 korrik 2026



Për vitin shkollor 2026-2027, në afatin e parë në çerdhet e komunës sonë janë regjistruar këta fëmijë:

<i>Tulipanët</i>	<i>Fëmijë</i>
Rahovec	191
Xërxe	63
Krushë e Madhe	1
Ratkoc	10

Në vitin shkollor 2025-2026, në këto çerdhe kanë vijuar aktivitetet edukative 327 fëmijë.

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2025-2026.

	Kaluan	Përsëriten klasën	Gjithsej
Klasa e I	541	23	564
Klasa e II	519	20	539
Klasa e III	518	21	539
Klasa e IV	552	12	564
Klasa e V	509	12	521
Klasa e VI	516	39	555
Klasa e VII	518	54	572
Klasa e VIII	533	72	605
Klasa e IX	558	49	607
Totali	4764	302	5066

Nr	Emri i shkollës	Vendi	Mungesat e nxënësve me arsyë 1-5	Mungesat e nxënësve pa arsyë 1-5
1	SHFMU"Isa Boletini"	Rahovec	7554	2678
2	SHFMU"Bekim Sylka"	Rahovec	1387	275
3	SHFMU"Sadedin Hajda"	Rahovec	1148	177
4	SHFMU"Gëzim Hamza-Piktori"	Rahovec	809	976
5	SHFMU"liria"	Fortesë	1068	468
6	SHFMU"Sapniq"	Sapniq	560	143
7	SHFMU"Dëshmorët e lirisë"	P. l Ullët	710	170
8	SHFMU"Hamëz Thaçi"	Xërxe	1608	1373
9	SHFMU"Skënder Kastrioti"	M.e Vogel	993	670
10	SHFMU"4-Dëshmorët"	Ratkoc	1594	467
11	SHFMU"Tre Dëshmorët"	Vrajakë-Bratotin	586	366
12	SHFMU"Rudolf Walther"	Dejnë	1618	773
13	SHFMU"Rilindja"	Çifllak	1528	757
14	SHFMU"Mustafë Ibishi"	Kramovik	956	757
15	SHFMU"Stylejman Vokshi"	Palluzhë	290	21
16	SHFMU"Milaim Krasniqi"	Pastasel	175	104
17	SHFMU"Vëllazërit Frashëri"	Drenoc	625	521
18	SHFMU"Dëshmorët e Zatriqit"	Zatriq	68	33
19	SHFMU"Bajram Curri"	Krushë e Madhe	2215	468
20	SHFMU"Faik Konica"	Celinë	39	183
21	SHFMU"Heronjtë e Kosovës"	H.e Vogël	392	148
22	SHFMU"Haki Stërmilij"	Zaqishtë	279	141
23	SHFMU"Lidhja e Prizrenit"	Apterushë	338	98
24	SHFMU"Sakip Bellaga"	P.i Epërm	119	112
25	SHFMU"Nesemi Elshan"	Nagavc	220	169
26	SHFMU"31 Marsi"	Guri Kuq	330	212
27	SHML"Xhelal Hajda-Toni"	Rahovec	/	/
28	SHML"Ukshin Hoti"	Krushë e Madhe	/	/
29	SHML"12 Maji"	Ratkoc	/	/
30	SHML"Selaidin Mulliaabazi-Mici"	Rahovec	/	/
32	SHUM "Faik Sylka	Rahovec	/	/
	Totali		17201	7283

Nr	Emri i shkollës	Vendi	Mungesat e nxënësve me arsyë-6-9	Mungesat e nxënësve pa arsyë--6-9
1	SHFMU"Isa Boletini"	Rahovec	8281	6010
2	SHFMU"Bekim Sylka"	Rahovec	4099	2233
3	SHFMU"Sadedin Hajda"	Rahovec	2079	2906
4	SHFMU"Gëzim Hamza-Piktori"	Rahovec	2960	4920
5	SHFMU"liria"	Fortesë	1148	975
6	SHFMU"Sapniqi"	Sapniq	522	337
7	SHFMU"Dëshmorët e lirisë"	P. I Ulët	1096	539
8	SHFMU"Hamëz Thaçi"	Xërxe	5067	2427
9	SHFMU"Skënder Kastrioti"	M.e Vogel	2293	1456
10	SHFMU"4-Dëshmorët"	Ratkoc	4533	3155
11	SHFMU"Tre Dëshmorët"	Vrajakë-Bratotin	551	1259
12	SHFMU"Rudolf Walther"	Dejnë	2488	3489
13	SHFMU"Rilindja"	Çiftllak	1293	3015
14	SHFMU"Mustafë Ibishi"	Kramovik	1383	1612
15	SHFMU"Styelman Vokshi"	Palluzhë	433	174
16	SHFMU"Milaim Krasniqi"	Pastasel	680	482
17	SHFMU"Vëllezërit Frashëri"	Drenoc	1664	2047
18	SHFMU"Dëshmorët e Zatriqit"	Zatriq	162	104
19	SHFMU"Baïram Curri"	Krushë e Madhe	3883	3055
20	SHFMU"Faik Konica"	Celinë	2917	1467
21	SHFMU"Heronjtë e Kosovës"	H.e Vogël	1001	357
22	SHFMU"Haki Stërmilli"	Zaqishtë	455	87
23	SHFMU"Lidhja e Prizrenit"	Aptershë	849	735
24	SHFMU"Sakip Bellaq"	P.i Epërm	610	171
25	SHFMU"Nesemi Elshanj"	Nagavc	1645	817
26	SHFMU"31 Marsi"	Guri Kuq	1072	435
27	SHML"Xhelal Hajda-Toni"	Rahovec	/	/
28	SHML"Ukshin Hoti"	Krushë e Madhe	/	/
29	SHML"12 Maji"	Ratkoc	/	/
30	SHML"Selajdin Mullabazi-Mici"	Rahovec	/	/
32	SHUM "Faik Sylka"	Rahovec	43	21
Gjithsej			25239	22265

	Nr. i paraaleleve	Nr i nx.	Shkëlq.	Sh. mirë	Mirë	Mjaft.	Me një notë të dobët	Me dy nota të dobëta	Me tri e më shumë nota të dobëta
Klasa X-të	22	348	59	72	101	25	8	16	8
Klasa XI-të	23	314	84	68	67	47	13	6	0
Klasa XII- të	22	309	75	52	85	57	14	6	0
Total	67	971	218	192	253	129	35	28	8

	Kanë përsëritur	Të panotuar	Totali	Mungesat				
				Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Total		
Klasa X-të	8	51	348	5571	7127	12698		
Klasa XI-të	0	29	314	5725	5677	11402		
Klasa XII- të	8	12	309	4592	7147	11739		
Total	16	92	971	15888	19951	35839		

Rezultatet e testit të Arritshmërisë

Në testin e arritshmërisë ishin të regjistruar gjithsej **608 nxënës**. Testit iu nënshtruan **576 nxënës**, ndërsa rezultati mesatar i testit të arritshmërisë është **38.84%**


Testi i Maturës – Rezultati

	Të testuar	Kaluan + %	Nuk kaluan + %
“Xhelal Hajda – Toni”	121	83 – 68.58%	38 – 31.41%
“Selajdin Mullabazi-Mici”	69	36 – 52.17%	33 – 47.82%
“Ukshin Hoti”	38	18 – 47.36%	20 – 52.63%
“12 Maji”	33	9 – 27.27%	24 – 72.72%
Totali	261	146 – 55.93%	115 – 44.06%


Regjistrimi (shtator 2025) kundrejt suksesit të gjysmëvjetorit të dytë (qershor 2026) • Viti shkollor 2025/26

6.135	6.037	98	1,6%	92,0%
Regjistrim	Sukses GJV2	Diferenca	Diferenca %	Kalueshmëria

Regjistrim kundrejt suksesit



Struktura e suksesit



- Shkëlqyeshëm
- Sh. mirë
- Mirë
- Mjaftueshëm
- Me nota të dobë
- Të tjera


Krahasimi gjinor

	Meshkuj	Femra
Nxënës	3.153	2.884
Kalueshmëria	88,8%	95,5%
Shkëlqyeshëm	30,3%	49,0%

Struktura e detajuar

Shkëlqyeshëm	2.366	39,2%
Sh. mirë	1.251	20,7%
Mirë	1.263	20,9%
Mjaftueshëm	674	11,2%
Të pa notuar	202	3,3%
Me një notë të dobët	116	1,9%
Me dy nota të dobëta	126	2,1%
Kane persentur klasen	21	0,3%
Me tri e më shumë nota t...	8	0,1%
Përcillen me nota negati...	10	0,2%

Kalueshmëria sipas klasave (%)



Diferenca brenda kufrive të pritur.